



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “TSR” Sh.P.K. të datës 05.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri” me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “TSR” Sh.P.K. e datës 05.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri” me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 30.11.2023 i autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “TSR” Sh.P.K. se ky aktivitet i prokurimit tanimë është kthyer në **RIVLERËSIM** përmes vendimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit lidhur me një kërkesë për rishqyrtim të një tenderuesi tjetër lidhur me aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “TSR” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “TSR” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 05.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Ndriçimi për sinjalizues për vendkalime për siguri” me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“Në sqarimet e dt.16.06.2023 janë lejuar dhe pranuar specifikat ekuivalente, prandaj edhe ne kemi ofertuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe sqarimeve të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit.

Sa i përket arsyes së parë të eliminimit, ju sqarojmë se: • Mostra 31 “treguesi (laterik) tre ngjyrësh per automjete Ø 300x3 i teknologjise Power LED, “ Mostra për pozicionin 31 e ofruar nga ne është ofruar sipas specifikave teknike të kërkuara. Ne baze të specifikimeve të produktit edhe pse Ø 300x3 është i kërkuar, vetëm e kuqja D 300, duhet të dalloj ne aspektin e formatit nga ngjyra verdhe edhe jeshile, megjithatë aty të ky produkt ndodhen të dyja dimensionet D 300 edhe d 200 sipas 4/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim të vendimit në AK nevojës, mund të jene tre D 300, dhe 1, d300x2 d200, d200x3 etj. Pra, ne e plotësojmë këtë kërkesë dhe rezulton se arsyeja e eliminimit është e paqëndrueshme.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit ju sqarojmë si në vijim: • Mostra 34 “ treguesit smart semaforik 3 ngjyresh per vetura” Mostrat për pozicionin 34 e ofruar nga ne është ofruar sipas specifikave të AK-se. Ky ze është i njëjti me mostren që është kërkuar në zërin 31 pastaj nuk ka pasur arsye të sjellim tjetër Semafor pasi është e njëjta, veçse përmban Edhe Pajisjen Smart që është e bashkangjitur, bashkë me kamerën me sensor për rregullimin e trafikut në ane të transferimit të shpejt . Duke pasur parasysh këtë sqarim, rezulton se ne jemi eliminuar pa të drejtë dhe arsyetimi i eliminimit është i paqëndrueshëm.

Sa i përket arsyes së tretë të eliminimit ju sqarojmë si në vijim: • Mostra 69 “LED markerit (K37) me karakteristika minimale ose ekuivalente” E bardhë e dyanshme, ndriçimi i lartë dhe intensiteti i dritës, rezistent ndaj dritës fantazmë, diametër 144 mm, (duhet të jete me e vogel=144) maksimum 4 mm mbi sipërfaqen e rruges, furnizimi me energji 24 VDC, konsumi 2.88+C8 W, intensiteti i dritës 75 cd, 12 copa LED 5 mm, kendi i shikimit 15° , temperatura e ambientit -25 °C deri në 85 °C shkalla e mbrojtjes IP68, IK10 mundësia e kontrollit të dritës - ndriçimi i rregullueshëm, ndërlihdja e burimeve të dritës për kompensimin automatik të dritës në rast të dështimit të LED-ve individuale, pjesa e sipërme e kutisë është prej çeliku inox rezistent ndaj pastrimit të borës dhe gërvishetjeve, pjesa e poshtme e kabinës është bërë prej alumini, rezistent ndaj ujit të kripur, nivele mbrojtjeje IP68. rezistenca mekanike deri në 160 ton. Edhe kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme, sepse në baze të kërkesës suaj për produkte ekuivalente, ne kemi paraqitur këtë produkt si kusht minimal të plotësimit të kërkesave të dosjes së tenderit. Gjatë fazës së tenderimit dhe pyetjeve - përgjigjeve, dhe ankesave është thënë që diametri dhe mënyra fizike e paraqitur e produktit mjafton të përmbushin kushtet në mënyrë ekuivalente, dhe jo domosdoshmërisht sipas specifikimeve teknike rigoroze”.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, parashtruesi me datë 19.06.2023 ka parashtruar edhe ankesë në OSHP. Rrjedhimisht me datë 05.09.2023 OSHP ka marrë vendimin me nr. 2023/0410 përmes të cilit ndër të tjera ka konfirmuar lejimin e dorëzimit të mostrave ekuivalente me mostrat e kërkuara përmes dosjes së tenderit. Parashtruesi të gjitha pretendimet e tij i ka parashtruar ashtu që ka pretenduar se të gjitha mostrat e dorëzuara janë ekuivalente me ato që janë kërkuar përmes dosjes së tenderit. Në anën tjetër komisioni vlerësues në raportin e vlerësimit nuk ka përcaktuar fare nëse mostrat e dorëzuara janë ose nuk janë ekuivalente me ato që janë kërkuar përmes dosjes së tenderit. Prandaj me rastin e rivlerësimit është e domosdoshme që komisioni për rivlerësim të sqaroj nëse në këtë rast kemi të bëjmë me mostra ekuivalente me ato në dosjen e tenderit.

Prandaj ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim. Në këtë mënyrë është konstatuar se kërkesa për rishqyrtim duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar.

Vlen të shtohet fakti se parashtruesi disa pretendime i ka drejtuar kundër tenderuesve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë është fakt i pakontestueshëm se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 30.11.2023 oferta e parashtruesit është cilësuar si ofertë e papërgjegjshme. Nga ky kënd i vështrimit (përderisa parashtruesi e ka statusin e tenderuesit të papërgjegjshëm) parashtruesi nuk mund të dëshmoj asnjë interes material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit. Me fjalë të tjera në raport me këto pretendime ankimore, parashtruesi nuk është dëshmuar si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se *“Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Përmes nenit 59 paragrafit 1 të RRPP është përcaktuar se *“kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar...”*. Në këtë mënyrë është gjetur se këto pretendime janë të palejuara në kuptim të nenit 59 paragrafit 1 të RRPP për shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit përmes zyrtarit bartës të aktivitetit të prokurimit si dhe anëtarëve të komisionit vlerësues ka konfirmuar se parashtruesi i ka sjellur mostrat të cilat gabimisht është konstatuar se nuk i ka sjellur. Pra mostrat janë sjellur mirëpo nuk janë shqyrtuar fare nga komisioni vlerësues. Natyrisht se ky veprim është në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP dhe nenin 40 të RRPP. Në këtë mënyrë është konfirmuar se pretendimet ankimore janë të bazuara në tërësi.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj është vendosur që kërkesa për rishqyrtim të miratohet si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.12.2023

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.